



INSTITUTI I KURRIKULËS DHE TRAJNIMIT

PROGRAMET E KURRIKULËS ME ZGJEDHJE TË GJIMNAZIT

FUSHA: TEKNOLOGJIA

LËNDA: TIK I AVANCUAR

(MODULI: WEB DESIGN dhe DREAMWEAVER)

KODI: 9.01

PROGRAMI I MODULIT WEB DESIGN DHE DREAMWEAVER

PËR KLASËN E 10

TIRANË, NËNTOR 2008

World Wide Web (WWW) është sot pjesë e jetës sonë dhe duke u bazuar në interesin e nxënësve u mendua që të vendosej moduli Web Design-Dreamweaver . Web Design-Dreamweaver është 1 modul për ata studentë të cilët janë të interesuar dhe kanë dëshirë për krijimin e faqeve të Internetit, duke përfshirë faqe të nivelit fillestar, dhe të avancuara.

Moduli Web Design-Dreamweaver që do zhvillohet në klasën e 10 do t'u japë njohuri nxënësve për të gjitha hapat që ndiqen për krijimin e një Websiti, duke u siguruar atyre njohuritë e nevojshme teorike dhe praktike të realizimit të Websitit. Zgjedhja e këtij moduli nuk kërkon domosdoshmërisht njohuri të nevojshme që lidhen me aplikimet Web, kështu që çdo nxënës, pavarësisht nga niveli, ka mundësi ta zgjedhë. Përfundimi me sukses i këtij moduli do t'u sigurojë nxënësve jo vetëm një formim në lidhje me fushën e krijimit të Webpageve, por, gjithashtu, do t'u japë mundësi nxënësve të motivuar që të përparojnë në drejtim të krijimit të Websiteve profesional.

1. SYNIMI I LËNDËS

Ky modul për klasën e 10 synon:

Aftësimin e nxënësve të kuptojnë mënyrën e funksionimit të faqeve të Internetit; të ndërtojnë Webpage të dizenuara (të paraqitura) mirë, të efektshëm në realizim dhe ndërvepruese; të njohë procesin e krijimit të Website, duke filluar me konceptimin, disenjimin, zhvillimin, testimin, publikimin dhe mirëmbajtjen.

2. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Në përfundim të këtij moduli nxënës/i, - ja:

- të përshkruajë etapat në të cilat kalon realizimi i një faqe Web;
- të zotërojë konceptet bazë për strukturën e një faqe Web;
- të përdorë elementët bazë të gjuhës HTML;
- të përdorë elementët bazë të CSS;
- të përdorë komandat dhe mjete kryesore të programit Dreamweaver për të krijuar strukturën e WebPage;
- të krijojë WebSite në Dreamweaver me faqet e krijuara.

3. OBJEKTIVA SIPAS LINJAVE

KLASA 10

36 javë x 1 orë = 36 orë

Linja 1: Hyrje në WebPage Design.

Përshkrimi i linjës: Nxënës/i,-ja kupton si funksion një WebSite, kompozimin e tij nga Webpage që lidhen me njëra tjetrën, dhe mënyrat e realizimit të tij deri ne fazën përfundimtare të publikimit dhe njihet me stadet e krijimit të sitit Web.

Orët e sugjeruara: 7orë

Linja	Objektiva
Hyrje në WebPage Design	Në përfundim të këtij moduli nxënës/i,-ja: <ul style="list-style-type: none">▪ të përshkruajë stadet e krijimit të një faqe Interneti, siç janë konceptimi, disenjimi, zhvillimi, testimi, publikimi dhe update (përditësimi);▪ të njihet me disa nga problemet kryesore që shoqërojnë realizimin e Website-it;▪ të zotërojë konceptet Web, WebBrowser, Webpage, template, HTML, domain name, website hosting, URL, Web server, FTP.

Linja 2: Ndërtimi i një faqeje Interneti

Përshkrimi i linjës: Nxënës/i,-ja kupton elementët bazë të gjuhës HTML, njihet me funksionet e tageve kryesore, dhe mënyrën se si mund të shikohet kodi i një faqeje dhe editimi i tij. Ai fillon të krijojë modele të thjeshta faqesh Interneti duke përdorur editorë teksti ose Dreamweaver.

Orët e sugjeruara: 13

Linja	Objektiva
Ndërtimi i një faqeje Interneti	Në përfundim të këtij moduli nxënës/i,-ja:

	<ul style="list-style-type: none"> ▪ të dallojë funksionet e tageve kryesore të gjuhës HTML; ▪ të përdorë editor teksti si psh: notepadi, frontpage ose dreamweaver për ekzekutimin e tyre; ▪ të realizojë lidhjen e faqeve të ndryshme me linke ndërmjet tyre; ▪ të dallojë URL absolute nga ato relative; ▪ të zbatojë ngjyra, tipa fontesh, vendosje imazhesh, audioklipe në faqet e krijuara të Internetit; ▪ të përdorë framet, tabelat, hyperlinket në faqet e krijuara të Internetit; ▪ të përdorë në mënyrë të përshtatshme HTML Forms, siç janë p.sh.: tekst fields, radio buttons, checkboxes, dropdown list, selection form, tekst ares etj.
--	--

Linja 3: Përdorimi i CSS

Përshkrimi i linjës: Nxënës/i,-ja njihet me një tjetër mjet ndihmës të fuqishëm për ndërtimin e faqeve të Internetit, siç është CSS (Cascading Style Sheet). Ai krijon seksione të veçanta në CSS, të cilat mund t'i përdorë si modele në faqet që do krijojnë në të ardhmen. Nëpërmjet CSS nxënësi që ka krijuar faqen e Internetit kontrollon stilin, layout dhe karakteristika të tjera të elementëve të ndryshëm në faqe, përnjëherësh, pra në të njëjtën kohë dhe nga i njëjti kod, dhe, kur dëshiron të ndryshojë një element, mjafton të ndryshojë kodin e CSS për të ndryshuar këtë element në të gjitha faqet.

Orët e sugjeruara: 5 orë

Linja	Objektiva
Përdorimi i CSS	<p>Në përfundim të këtij moduli nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të kuptojë rëndësinë e përdorimit të CSS në Webpages; ▪ të zbatojë kode të krijuara në CSS brenda HTML lidhur me stilimet e fonteve, ngjyrat, margin, borders, background të imazheve, pozicionim të elementëve, krijimin e kolonave etj; ▪ të përdorë elementët class, id, span, div

	për identifikimin dhe grupimin e elementëve të ndryshëm në Webpage.
--	---

Linja 4: Përdorimi i Dreamweaver

Përshkrimi i linjës: Nxënës/i,-ja njihet me një program të fuqishëm dhe aktual për krijimin e Website-ve siç është Dreamweaver. Në këtë linjë ata mund të ndërtojnë dhe menaxhojnë Website profesional duke përdorur programin Dreamweaver.

Orët e sugjeruara: 11 orë

Linja	Objektiva
Përdorimi i Dreamweaver	<p>Në përfundim të këtij moduli nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të kuptojë karakteristikat kryesore të programit Dreamweaver; ▪ të njohë komandat kryesore të faqes së punës; ▪ të krijojë faqe në Dreamweaver që përmbajnë tekst, imazhe, rollover imazhe, navigationbar, hiperlinke të jashtëm dhe të brendshëm, tabela etj; ▪ të krijojë template, layer, klasa, frame, animacione në Flash, duke përdorur programin Dreamweaver dhe duke i manipuluar ato.

4. Kërkesat që ka moduli WEB DESIGN - DREAMWEAVER ndaj lëndëve të tjera të kurrikulës bërthamë

Ky modul realizon dhënien e njohurive teorike dhe praktike për mënyrën e funksionimit dhe krijimit të faqeve të Internetit. Moduli WEB DESIGN - DREAMWEAVER nuk kërkon njohuri paraprake në fushën e programimit ose të dizenjimit të faqeve Web. Të vetmet njohuri që kërkohen janë ato që lidhen me konceptet bazë të lëndës së TIK-ut.

WEB DESIGN - DREAMWEAVER	TIK
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Menaxhimi dhe organizimi i fileve ▪ Përdorimi i pajisjeve të Input-Outputit 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të organizojë filet, në direktori dhe në shkallë hierarkie. ▪ Të përdorë pajisjet usb, cd, dvd etj., për shkrim dhe lexim materialesh.

5. KËRKESA PËR ZBATIMIN E MODULIT

Zbatimi i këtij moduli, WEB DESIGN - DREAMWEAVER, u siguron nxënësve një mundësi të mirë për njohjen e fushës së Webdesign-it dhe realizimin konkret të faqeve të Internetit në mënyrë individuale. Realizimi me sukses i këtij moduli kërkon kushtet e nevojshme, siç janë pajisja me laboratorë kompjuterik dhe me programin e DREAMWEAVER, i cili mund të jetë version DREAMWEAVER 8 ose Dreamweaver i versioneve më të reja. Programi është ndërtuar në atë mënyrë që të studiojë dhe përfshijë njohuritë dhe komandat që janë të njëjta për të gjitha versionet, prandaj nuk përbën problem në qoftë se punohet me version të ri të Dreamweaver-it. Moduli i WEB DESIGN - DREAMWEAVER duhet t'i nxitë nxënësit të jenë aktivë dhe të marrin përgjegjësi për të mësuarit e tyre; të përdorin strategji dhe teknika mësimore që nxitin ndërveprimin, aftësitë krijuese, pjesëmarrjen mësimore dhe mbështetin punën e tyre në fushën e bukur dhe të pafund të Webdesign-it. Zbatimi i modulit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore, fetare.

Objektivat e modulit

Objektivat e modulit janë për të gjithë nxënësit që do të thotë se të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia të nxënë çka përshkruhet tek objektivat. Realizimi i objektivave në tematika ose linja dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të modulit.

Një objektivi përmbushet në nivele të ndryshme nga nxënës të ndryshëm. Mësuesi dhe autorët e materialeve mësimore duhet të marrin parasysh të gjitha nivelet e nxënësve.

Orët mësimore

Moduli i WEB DESIGN - DREAMWEAVER –it është strukturuar në linja që vijnë njëra pas tjetrës, por kjo nuk do të thotë se mësimdhënia dhe të nxënës duhet të zhvillohet në këtë renditje gjatë vitit shkollor.

Nxënësit do të praktikojnë krijimin e faqeve të Internetit dhe do të krijojnë Website në forma dhe modele të ndryshme të cilat lidhen me njëra tjetrën, duke i realizuar ato në mënyrë profesionale përgjatë 36 orëve të vëna në dispozicion për këtë modul.

Sasia e orëve mësimore për secilën linjë është rekomanduese. Përdoruesit e modulit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, por janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën linjë. Domethënë, mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë kur vë re se nxënësit e tij hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave të linjave, por mund të ecë më shpejt kur nxënësit e tij demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm.

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban :

- përsëritjen brenda një linje ose tematike të njohurive bazë të tij (njohja me konceptet e faqes së Internetit, stadet në të cilat kalon realizimi i faqes së Internetit, komandat kryesore të menuve dhe të paletave të programit Dreamweaver);
- realizimi i faqeve të internetit të shkëputura dhe me karakteristika të ndryshme dhe më vonë lidhja e tyre për të krijuar një Website;
- realizimin e veprimtarive të ndryshme krijuese;
- realizimin e projekteve sipas tematikave të vendosura për realizimin e projektit, eseve, detyrave të ndryshme me karakter krijues.

Në orët mësimore, që i përkasin përpunimit të njohurive dhe të aftësive, mësuesi zhvillon edhe tema me nismën e tij ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto tema mund të nisen nga kureshtja e nxënësve ose nga nxitës të tjerë.

Gjatë përpunimit të njohurive duhet t'i kushtohet kohë e posaçme kultivimit të:

a. Aftësive të posaçme lëndore si:

Aftësi krijuese

- krijimi në tipa dhe modele të ndryshme i faqeve të Interneti (personale, prezantuese etj).
- krijimi i faqeve që janë dinamike nga përmbajtja dhe përditësimi (update) i materialit.

Aftësi analizuese

- analiza e faqeve të realizuara në përshtatje me qëllimin, funksionin dhe shfaqjen e tyre në browsera të ndryshëm.

b. Formimit të qëndrimeve, si: qëndrimi kritik, etiko-social etj.

Për realizimin cilësor të modulit të WEB DESIGN - DREAMWEAVER është e domosdoshme që çdo shkollë të ketë laboratorin e (TIK) me një numër të mjaftueshëm kompjuterësh të pajisur me programin e Dreamweaver. Është e rëndësishme edhe prania e pajisjeve të tjera ndihmëse siç janë: printer, skaner, videokamera, aparate fotografik digjital. Prania e Internetit do t'u ofronte një ndihmë nxënësve dhe mësuesve për realizimin sa më mirë të këtij moduli. Gjithashtu, për zbatimin me sukses të këtij moduli, është mirë që mësuesi të përdorë metodat e nxitjes gjatë procesit të vëzhgimit dhe të krijimit, që shërben për një orientim dhe fokusim profesional.

6. VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj. Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e modulit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në modul. Objektivi i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet analizuese në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti.

- Mësuesi zhvillon vetë e ndihmon nxënësit dhe bashkënxënësit të zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi.
- Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënësi vlerësohet me notë ndërsa demonstroi arritjet e tij nëpërmjet veprimtarish e produktesh të tjera, si: krijimin e faqeve të Internetit të cilat janë të paraqitshme, efektive dhe komunikojnë me njëra-tjetrën.
- Vlerësimi i kontributit gjatë punës në grup për realizimin e një Websiti të përbërë nga shumë faqe.
- Vlerësimi për organizimin e materialit dhe hapat që ndjek nxënësi gjatë realizimit të punës.
- Vlerësimi përmes detyrave ose angazhimeve individuale të nxënësve (detyra praktike, projekte, risi etj.)

Në punime të nxënësve me grupe të vogla, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe të vendosë nota në regjistrë për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë si partnerë rreth përvetësimit të njohurive të fituara të orëve të kaluara dhe mirë kryerjes së detyrave jashtë klase. Herë pas here, mësuesi duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor për një lëndë ose modul të caktuar. Ai mund të përmbajë krijime të ndryshme përgjatë vitit, si: faqe Interneti të tipave dhe modeleve të ndryshme, përpunime dhe editime që u janë bërë këtyre faqeve herë pas here nga ana e nxënësit në programin e Dreamweaver-it, detyra tematike, projekte kurrikulare, printime të faqeve të realizuara. Ai i përngjet një albumi me anën e të cilit mësuesi, nxënësi vetë dhe prindërit e tij gjejnë informacion të shpejtë dhe të sintetizuar rreth progresit të nxënësit. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, mësuesi rekomandon.